

Komuna e Podujevës

Raporti
i
Shqyrtimit Publik për Hartën Zonale të Komunës së
Podujevës
2021-2029

Podujevë, Nëntor 2021

Përmbajtja

1. Hyrje

HZK e Podujevës është përgaditur nga Komuna e Podujevës, bartëse e të cilit është Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis. Në këtë proces komuna është mbështetur nga ekipi i konsulentëve të GIZ, programi “Fuqizimi i planifikimit hapësinor dhe menaxhimi i tokës 2017-2019”

Përgatitja e HZK së Podujevës ka kaluar nëpër një proces të përfshirjes, pjesëmarrjes dhe konsultimit të akterëve të ndryshëm dhe palëve me interes të komunës dhe më gjerë gjatë gjithë kohës së përgatitjes së dokumentit. Mënyrat e përfshirjes kanë qenë të ndryshme përfshirë format e punëtorive me pjesëmarrje më të gjerë si dhe atyre më të fokusuara, konsultime, prezantime publike, intervista, takime, aktivitete dhe manifestime të ndryshme e deri te shqyrtimi publik si forma e fundit e pjesëmarrjes së publikut i cili ka qenë i hapur për 30 ditë dhe atë prej 4 shkurtit deri më 4 mars 2020 kur dhe është mbyllur.

Në kuadër të këtij raporti janë paraqitur fazat nga marja e vendimit për përpilimin e PZHK, shkurtimisht janë dhënë edhe sqarime rreth procesit të pjesëmarrjes dhe përfshirjes gjatë hartimit të dokumentit e deri te shpallja e shqyrtimit publik si dhe komentet e dala na kjo periudhë 30 ditore.

Pas marrjes së pëlqimit për aprovim nga MMPHI në Tetor të 2020, me qëllim të përmirësimit të këtij drafti, dhe adresimit të çështjeve kyçe të cilat do të ndikonin në rregullimin e përgjithshëm të hapësirës, në veçanti në zonën urbane të Podujevës, por edhe në zonat sub-urbane të saj, komuna ka ndërmarrë edhe një sërë takimesh me konsulentë ku janë adresuar të gjitha çështjet e ngritura. Drafti i përmirësuar është më i qartë dhe rrjedhimisht më i lehtë për implementim dhe është parë e udhës që i njëjti të ekspozohet edhe një herë në shqyrtim publik- për një kohëzgjatje prej 1 muaj.

2. Vendimi i KK-së dhe njoftimi i ndërmarrë për shqyrtimin publik të plotësimeve të HZK-së

Vendime momentet kyçe të vendim marrjes dhe pjesëmarrjes janë:

- a. Vendimi i Kuvendit Komunal për vënien në shqyrtim publik të draft-HZK me plotësimet: 19 Shtator 2017
- b. Njoftimi për prezantimin publik të projekt-HZK-së shpallur në uebfaqen e komunës: 27 shtator 2021
- c. Hapja e shqyrtimit publik dhe prezantimi i draft-HZK në sallën e Kuvendit Komunal: 20 tetor 2021
- d. Ekspozimi i draft-HZK-së me plotësimet gjatë periudhës: 20 tetor – 20 nëntor 2021



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 17 shkronja b), 40.2 shkronja l) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 5 paragrafi 1.2.2, nenit 10 paragrafi 2.1, nenit 11 paragrafi 1.12 dhe nenit 20 të Ligjit nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor, nenin 7 paragrafi 2, dhe 8 paragrafi 2, 4 si dhe 12 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2014 (MMPH) për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neneve 14 dhe 15 parag. 2.4 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 35 shkronja o), dhe 37 pika 4 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr.01/18-02 të datës 31 janar 2011, në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-948/03-0072034/17 dt.19.09.2017 për fillimin e hartimit të Hartës Zonale, Vendimit nr.prot.01-450/05-0063175/21 me të cilin autorizohet dhe obligohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së mjedisit për përgatitjen e plotësim ndryshimeve të dokumentit të projekt Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2020-2028 i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 30 korrik 2021, si dhe aktit të vlerësimit të përputhshmërisë nr.prot.SP-0271162-2/19 të datës 17.01.2021 të MMPH, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2021, miratoi këtë;

VENDIM PËR VËNIEN NË SHQYRTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në shqyrtim publik;

➤ **Projekt Harta Zonale e Komunës së Podujevës (HZ) 2020-2028, me ndryshimet dhe plotësimet e hartuara nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, konform Vendimit nr.prot.01-450/05-0063175/21 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 30 korrik 2021, dhe atë;**

- Harta Zonale e Komunës, periudha 2021-2029
- Rishikimi i blloqeve dhe etazhitetit në zonën urbane
- Rishikimi i dispozitës së projekt Hartës Zonale bazë, për përfshirjen e ndërtesave bujqësore në tokë bujqësore
- Rishikimi i kufirit të tokës ndërtimore në fshatrat përreth qytetit (për gjithsej 10 vendbanime)
- Rishikimi i koeficientit të ndërtimit në vendbanimet përgjatë rrugës Podujevë-Prishtinë (për gjithsej 12 vendbanime)
- Rishikimi i kufirit të zonës ekonomike

Neni 2

1. Njoftimi publik për projekt Hartën Zonale të Komunës së Podujevës 2021-2029 bëhet së paku 8 (tetë) ditë para hapjes së shqyrtimit publik.
2. Shqyrtimi publik sipas nenit 1, zgjat 30 ditë dhe fillon nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Shqyrtimi publik mbahet konform dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, me theks *Udhëzimit Administrativ nr.05/2014 (MMPH) për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor* dhe organizohet nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM e cila gjatë kësaj periudhe, ndër të tjera, prezanton pjesën grafike dhe tekstuale të ndryshimeve dhe plotësimeve projekt Hartës Zonale të Komunës së Podujevës.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet lidhur me dokumentin në fjalë mund të paraqiten gjatë periudhës së shqyrtimit publik përmes debateve të drejtpërdrejta me qytetarë, në formë të shkruar në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit - ndërtesa e re e Komunës, sipas njoftimit publik, si dhe në formë elektronike në e-mail adresën; masar.qitaku@rks-gov.net; të cilat përcjellën në DPUMM brenda periudhës së shqyrtimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, përkatësisht projekt Harta Zonale e Komunës së Podujevës me plotësim ndryshimet e hartuara nga DPUMM, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (rubrika; aktet për diskutim publik)

Neni 5

1. Shqyrtimin publik obligohet ta zbatoj Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e cila po ashtu përgatitë raportin për shqyrtimin publik përkatës dhe jep sqarime dhe arsyeshmëri rreth pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.
2. Gjatë periudhës së shqyrtimit publik sipas këtij vendimi, DPUMM bashkëpunon dhe koordinon me Zyrën për marrëdhënie me publikun dhe informim.

Neni 6

Pas përfundimit të shqyrtimit, DPUMM ndërmerr të gjitha veprimet e parapara ligjore për finalizimin e dokumentit të Projekt HZ-së, dhe procedimit të tij në Kuvendin e Komunës së Podujevës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ndërsa anulohet Vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-070/05-0056357/21 i datës 13 korrik 2021.

Nr.01-350/05-0085317/21
Podujevë,
27 shtator 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Hapet shqyrtimi publik – Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2021-2029

Bazuar në nenin 4, neni 11 dhe neni 20 të Ligjit për Planifikim Hapësinor 04/L-174, neni 5, 6, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat e pjesëmarrjes së publikut në planifikimin hapësinor. Vendimin e Kuvendit të Komunës së Podujevës Nr. 01-350/05-0085317/21, Dt. 27.09.2021 për vënien në shqyrtim publik të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës. Komuna e Podujevës – Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Miedisit Planifikimit Hapësinor shpallë:

NJOFTIM PËR HAPJEN E SHQYRTIMIT PUBLIK

Projekt dokumenti – Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2021-2029

Komuna e Podujevës fiton axtetarët, sektorin publik dhe privat, eksteratët, dhe të gjithë të interesuarit që të marrin pjesë në procesin e Shqyrtimit Publik të Projekt dokumentit – Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2021-2029.

Qëllimi i organizimit të shqyrtimit publik, si pjesë e procesit të hartimit të Hartës Zonale të Komunës, është që të përcaktohet dhe vlerësohet komentet të cilat shërbejnë për vlerësimin e cilësisë së dokumentit, para dorëzimit të tij në miratimin përfundimtar në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe në Kuvendin e Komunës.

Shqyrtimi publik Projekt dokumenti – Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2021-2029 do të zhvillohet nga data 20 tetor deri më 20 nëntor, çdo ditë mune nga ora 10 deri ne orën 12, në sallën e Kuvendit të Komunës së Podujevës në objektin e Ri Katin përdhës faqen zyrtare të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeva/urbanizem/hartat-zonale/>

Kundërshtimet, komentet apo sugjerimet ne Projekt dokumentin – Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2021-2029 mund të paraqiten në formë të shkruar gjatë periudhës së shqyrtimit publik deri më 20 nëntor 2021 dhe i adresohen Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Miedisit, ndërtesa e komunës, katë I-të, ose në emailin zyrtar: masar.qitaku@rks-gov.net.

Materiali në kopje fizike dhe sarrimet nga stafi do të zhvillohen në Ndërtesën e Komunës së Podujevës, në katin e I-të, ndërsa kundërshtimet, komentet, sugjerimet dhe propozimet mund të shkruhen në lixhin e prezentuar në periudhën dhe orarin ditor të përcaktuar sipas këtij njoftimi.


Draft-dokumentit i Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2021-2029 ka kaluar të gjitha fazat e paraparë me ligjet në fuqi deri në fazën e shqyrtimit publik dhe paraqet rezultatin e një pune të përbashkët të profesionistëve të fushave të ndryshme dhe përfaqësuesve nga sektorët relevantë të Komunës së Podujevës dhe Qeverisë së Kosovës.

Gjatë periudhës së shqyrtimit publik, do të organizohet takime me profesionistët, grupet e interesit, përfaqësuesit e institucioneve etj sipas tregullave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Draft-dokumentit i Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2021-2029 është i publikuar në WEB – FAQEN: <https://kk.rks-gov.net/podujeve/hartat-zonale/> si dhe është e publikuar në korridorin e Katit I-të në ndërtesën e Komunës.

Njoftimi për Shqyrtim Publik vendoset në muqet të informimit dhe në web –faqen e Komunës së Podujevës.


5. Përmbledhja e rekomandimeve dhe vërejtjeve nga aktiviteti i Shqyrtimit Publik

Nr	Burimi i rekomandimit	Komenti/vërejtja/sugjerimit	Pranohet/refuzohet	Arsyetimi i pranimit apo refuzimit të komentit
1	Nebih Musliu Pronar	<p>Kërkesë për ndërrim destinimin nga toka bujqësore në tokë ndërtimore e parcelës 00483-0</p> <p>Zona Katastrale Lluzhan Për ndërtimin e fabrikë spër prodhimin e betonit ku pjesa me e madhe e parcelës eshte tokë bujqësore</p>	<p>Refuzohet- sipas draftHZK-së, parashihet që vetëm një segment i parcelës të jetë zonë industriale. Shndërrimi i kësaj parcele në tokë ndërtimore, përkatësisht zonë industriale, do të dëmtonte në masë të konsiderueshme tokat bujqësore përreth.</p>	

Raport nga Shqyrtimi Publik për Hartën Zonale të Komunës

<p>2</p>	<p>Faton dhe Arton Aliu Pronar</p>	<p>Ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore e parcelës 00572-0 dhe 00572-1 zona katastrale Gllamnik</p> <p>Për ndërtimin e objektit afarist për shitjen e qeramikës afër magjstralës Podujevë Prishtinë ku si fillim do të punësohen 35 punëtorë</p>	<p>Pranohet-pasi që është e rrethuar me zhvillime të banimit.</p>	
----------	------------------------------------	---	---	--


Raport nga Shqyrtimi Publik për Hartën Zonale të Komunës

3	Mustafë Musa Pronar	<p>Ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore e parcelës 02228-0-zona kastastrale Orllan</p> <p>Ne si pronar të restorantit Adriatiku me një përvoj 17 vjeqare në Restorant dhe kërkesave të mëdha që vijnë për zgjerim të biznesit kërkojm që në këtë zonë të ndërtohet edhe një retorant ushqimorë me të gjitha standartet infrastrukturore.</p>	<p>Refuzohet bazuar në komentet e ministrisë që për zonat e mbrojtura, Ministria është përgjegjëse për planifikim.</p>	
---	---------------------------	---	--	--

Raport nga Shqyrtimi Publik për Hartën Zonale të Komunës

4	Altin Rekalju Pronar	Ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore e parcelave : Zona katastrale Orllan 01026-12- zona kadastraleOrllan Ndërtimin e 3 villa private	Refuzohet bazuar në komentet e Ministrisë që për zonat e mbrojtura, ministria është përgjegjëse për planifikim	
---	-------------------------	--	--	--

Report nga Shqyrtimi Publik për Hartën Zonale të Komunës

6	Qazim Zhitia Avdullahu Pronar	Ndryshim nga destinimi nga toka bujqësore në atë ndërtimore.zona katastrale Llugë Parcelat 00749-0,00753-0,00752-0,00751-0,00750-0,00754-5,00746-0,00747-0.	Pranohet dhe shndërrohet në zonë komerciale, për shkak të përfitimit socioekonomik që llogaritet të sjellë në qendrën e Lluzhanit.	
---	-------------------------------------	---	--	--

Raport nga Shqyrtimi Publik për Hartën Zonale të Komunës

<p>7 Salih Murati Pronar</p>	<p>Ndryshim destinimi nga toka bujqësore në atë ndërtimore. Zona katastrale Llapashticë e Poshtme Parcela:00726-0, 00727-0</p>	<p>Refuzohet sipas draftHZK-së, kjo është zonë bujqësore. Shndërrimi i kësaj parcele në tokë ndërtimore, do të dëmtonte në masë të konsiderueshme tokat bujqësore përreth.</p>	
------------------------------	--	--	--


Raport nga Shqyrtimi Publik për Hartën Zonale të Komunës

8	Adem Ahmeti Pronar	Ndryshim destinimi nga toka bujqësore në atë ndërtimore, zona katastrale Shakovicë Parcela:0065-0 00066-1,00064-1, 00062-0,00063-0, 00068-0,000662,00067-1,00067-3 00067-2,00069-0 00069-2,00069-1	Pranohet për shkak të qëllimit komercial	
---	-----------------------	--	--	--

Raport nga Shqyrtimi Publik për Hartën Zonale të Kosovës

Komisioni i shqyrtimit të komenteve nga Shqyrtimi Publik:

1. Bujar Hasani, kryetar
2. Veton Aliu, anëtar
3. Masar Çitaku, anëtar
4. Fidan Restelica, anëtar
5. Fidan Salihu, anëtar
6. Fatmir Latifi, anëtar



Handwritten signatures of the six members of the public review commission, each written on a horizontal line.

Vendi dhe data

Podujevë 23.11.2021